



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**KRYETARI I KRYEQYTETIT** 12. 09. 2023  
14-431/03-189584/23 më

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15 qershor 2008), nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Plotësohet-ndryshohet vendimi 01 Nr. 031 – 3111 i datës 20.12.2011 për ndalimin e dhënies së lejeve ndërtimore dhe lejeve të përdorimit për personat juridikë dhe fizikë të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet ndaj Komunës, si në vijim:

- 1.1. Të gjithë personat fizik dhe personat juridik që kanë obligime financiare ndaj Komunës së Prishtinës, u ndalohet dhënia e lejeve ndërtimore, duke përfshirë këtu procesin e pranimin teknik edhe procesin e legalizimit. Ky paragraf vlen për të gjithë personat fizik dhe për personat juridik, të cilët kanë obligime ndaj Komunës së Prishtinës dhe të cilët nuk janë në procedurë gjyqësore për kontestimin e borxhit.
- 1.2. Të gjithë personat fizik dhe personat juridik që kanë obligime financiare ndaj Komunës së Prishtinës, e të cilët para datës së marrjes të këtij vendimi, janë në procedurë gjyqësore me Komunën e Prishtinës për shkak se e kontestojnë borxhin (borxhet e vjetra) nuk mund t’ju bëhen pengesa për pajisje me leje të reja ose që të mos kenë pengesa në ofrimin e shërbimeve nga Komuna e Prishtinës, duke përfshirë këtu procesin e pranimin teknik edhe procesin e legalizimit, derisa nuk ka një vendim përfundimtar nga Gjykata. Kjo bëhet me qëllim që Komuna e Prishtinës të evitoj pasojat nga paditë eventuale për kompensimin e dëmit. Ky paragraf vlen për të gjithë personat fizik dhe personat juridik, të cilët kanë obligime ndaj Komunës së Prishtinës dhe të cilët në procedurë gjyqësore për kontestimin e borxhit.
- 1.3. Të gjithë personat fizik dhe personat juridik që kanë obligime financiare ndaj Komunës së Prishtinës, e të cilët janë në procedurë gjyqësore me Komunën e Prishtinës për shkak se e

kontestojnë borxhin, ose nuk janë në procedurë gjyqësore por që i kanë borxh Komunës së Prishtinës dhe të njëjtin dëshirojnë ta fshijnë borxhin, këtë mund ta bëjnë me marrëveshje të re për shlyerjen e borxhit me Komunën e Prishtinës përmes kësteve ose me procedurë të ndërmjetësimit mund t'i zgjidhin rastet kontestuese për borxhet e mbetura.

- 1.4. Në rastet kur ka dilema se e kujt është përgjegjësia për të shlyer obligimin ndaj Komunës, kur personi fizik dhe personi juridik janë të njëjtë, çështja trajtohet në një Komision të veçantë në përbërje nga Drejtoria e Urbanizmit dhe nga Zyra Ligjore.
- 1.5. Në rastet kur ka dilema se e kujt është përgjegjësia për të shlyer obligimin ndaj Komunës, kur personi fizik ose familjari i tij është themelues ose aksionar i personit juridik, çështja trajtohet në kuptim të ndarjes së përgjegjësive që nënkupton se personi fizik nuk mund të bartë barrën e obligimeve të personit juridik dhe anasjelltas. Rastet e tilla trajtohen nga një Komision i veçantë i themeluar nga Kryetari i Kryeqytetit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Inspektoratit si dhe Zyra Ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Urbanizmit;
- Drejtorisë së Financave;
- Drejtorisë së Inspektoratit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Zyrës Ligjore; dhe
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
Përparim Rama

